



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

09.10.2019
02/558

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/

Datë: 23.09.2019

Procesverbal

i mbledhjes së VIII (e tetë) për vitin 2019 e Komitetit për Politikë dhe Financa

REND I DITES

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Ndarja e mjeteve financiare me rastin e ndarjes së çmimeve sipas Statutit të Komunës për Ditën e Çlirimit dhe Ditën e Dëshmorëve të Komunës së Malishevës me 16 Qershor 2019.
3. Shqyrtimi i Raportit i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Qershor 2019.
4. Shqyrtimi i Raportit të DKA E-së për përfundimin e vitit shkollor 2018/2019 si dhe shqyrtimi i raportit për përgatitjet e fillimit të vitit shkollor 2019/2020.
5. Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë për Bujqësi për përfundimin e korrje-shirjeve.
6. Inicimi i procedurave për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Transparencën në Komunën e Malishevës.
7. Shqyrtimi i kërkesave.
8. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 23.08.2019, filloj në ora 10, morën pjesë 4 anëtarë të KPF, zyra për informim, përfaqësuesi nga OSBE.

Rrahim Morina: Ju përshëndes të gjithëve jemi në mbledhjen e tetë shpresoj që keni kaluar mirë pushimet. Mbledhja ka qenë e paraparë të mbahet me datën 21 por e kemi shtyre për sot me datën 23.02.2019. I kemi dy kërkesa njëra për një rreth rrotullim nga kryesia e fshatit Carrallukë dhe një kërkesë është nga kryesuesi i Komisionit Komunal të Aksionarëve, nëse s'keni diçka tjetër kush jeni për këtë rend të ditës? Unanimisht ishin 4 anëtar të pranishëm.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Rrahim Morina: Kush jeni për miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Unanimisht ishin 4 anëtar të pranishëm.

2. Ndarja e mjeteve financiare me rastin e ndarjes së çmimeve sipas Statutit të Komunës për Ditën e Çlirimit dhe Ditën e Dëshmorëve të Komunës së Malishevës me 16 Qershor 2019.

Rrahim Morina: Herave tjera atyre që ju kemi ndarë çmime mjetet i kanë marrë kesh e tani mjetet duhet ata ti marrin përmes xhirollogarisë bankare.

Alban Krasniqi: Zgjidhja mundet me kanë pa e ndryshuar vendimin sepse s'kemi nevojë, vetëm me nxjerr një vendim të përgjithshëm edhe ai vendim me vlejë edhe për herat e tjera, e aty me cek që mjetet meju nda edhe për vitin 2019.

Rrahim Morina: Kush jeni për rekomandimin e kësaj pikë për mbledhjen e Kuvendit? Unanimisht ishin 4 anëtar të pranishëm.

3. Shqyrtimi i Raportit i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Qershor 2019.

Hashim Vrenezi: Ne lidhur me raportet edhe kur po kërkojmë diçka material nuk po na sjellin, buxhetin te investimet kapitale kem vërejt se shpenzohet ngadalshëm dhe jo qysh e kemi buxhetuar në kuvend për investime kapitale.

Duhet të ketë një specifikacion për projektet e vitit 2019 të votuara në kuvend; sa projekte janë realizuar, sa projekte janë në fazën e realizimit dhe sa projekte presin të realizohen. Edhe te projektet dy vjeçare tenderimi a bërë në vitin paraprak.

Rrahim Morina: Ne nga drejtori i Financave kërkojmë sqarime me shkrim për kuvend.

Alban Krasniqi: Kur kemi mbledhje në kuvend mirë është me ba një marrëveshje me ndonjë kompani për furnizim me ujë për anëtar të kuvendit e jo kur donë me na sjellë, por ne me pas aty sa herë që ne kemi nevojë, pra me kanë dy aparate njëri në korridor me shërbye për çdo qytetarë dhe një në sallën e kuvendit. Te raporti gjashtë mujor nga takimet me qytetarë te projektet trotuar me kubëza këta kanë thënë se ka s'kemi e në anën tjetër po punojnë dhe janë në realizim, pastaj kërkoj përgjigje nga Drejtoria se pse nuk figuron që mjetet për nënat lehona për vitin 2019 ku janë shpenzuar ato mjete, sepse kuvendi ka marrë vendim meju nda nga 100 euro.

Rrahim Morina: Unë kam kërkuar nga drejtoria me shkrim sa lindje kemi pas pra një liste me emra pra për vitin 2019.

Alban Krasniqi: Sa projekte dhe sa vendimi nuk po zbatohen e nuk po dine se munden mu përballuar në Gjykatë e këto i bëjnë vetëm pse janë projekte te opozitës të propozuara dhe miratuar, atëherë pse tani ne jemi këtu.

Rrahim Morina: Kush jeni për rekomandimin e kësaj pikë për mbledhjen e Kuvendit? Unanimisht ishin 4 anëtar të pranishëm.

4. Shqyrtimi i Raportit të DKA E-së për përfundimin e vitit shkollor 2018/2019 si dhe shqyrtimi i raportit për përgatitjet e fillimit të vitit shkollor 2019/2020.

Raimonda Krasniqi: Në këtë raport s'kemi asnjë specifikacion por çdo gjë është në numrin shumë, thotë janë kryer shumë punë por jo në detaje se në cilat objekte shkollore është punuar, pastaj thuhet paisje shkollore e s'dihet se në cilat shkolla.

Alban Krasniqi: Nga drejtori i Arsimit duhet të dihet sa është shpenzuar dha a është realizuar në bazë të planifikimit të kuvendit buxheti i arsimit për vitin 2019. Të ketë një specifikacion për objektet e renovuara, çka është rinovuar, cilat objekte janë rinovuar dhe kur janë ndërtuar këto objekte që po rinovohen. Paramendoni çerdhja është ndërtuar ne vitin 2017 e tani i hiqen dritaret për te ja ndërruar, kanë investu mijëra euro në Shkollën e Turjakës e ajo shkollë parashihet të ndërtohet, po ashtu gjendja në shkollën e Vermicës është tmerr, fusha në Kijevë janë do tepiha aty afër s'dihet as për çka janë apo kur janë sjellë.

Rrahim Morina: Kush jeni për rekomandimin e kësaj pikë për mbledhjen e Kuvendit? Unanimisht ishin 4 anëtar të pranishëm.

5. Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë për Bujqësi për përfundimin e korrje-shirjeve.

Rrahim Morina: Ne e kemi një letër me pak fjalë, por si te doni ose e rekomandojmë për kuvend, ose e hjekim këtë pikë.

Hashim Vrenezi: Mirë është te dimë sa është realizuar buxheti për këtë linjë.

Alban Krasniqi: Buxheti a kanë i ndarë për fermer, me ditë sa ka qenë çmimi për korrje shirje, a kanë pas ndonjë problem krejt këto duhet mu përfshi e jo në këtë formë. Të na sillet një liste e aplikuesve të të gjitha subvencioneve të ndarë nga Drejtoria e Bujqësisë për vitin 2019, duke përfshirë edhe subvencionimin me farë dhe plehra.

6. Inicimi i procedurave për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Transparencën në Komunën e Malishevës.

Muharrem Morina: Ne e kemi këtë Rregullore për Transparencë që tani ju kemi sjellë, ne e kemi pas sjellë edhe Planin për transparencë tash është Udhëzimi i ri Administrativ që Rregullorja duhet mu harmonizu në bazë të Udhëzimit Administrativ. Në një takim që është mbajt ka marre pjesë zyra për

informim e që gabim ka qenë se zyrtaret ligjor nuk kanë marrë pjesë sepse nuk na ka ftuar askush, por prapë se prapë mbete nga Kuvendi i Komunës me vendose me tutje.

Alban Krasniqi: Për me ndryshuar këtë Rregullore është nevojë e kohës sepse janë shtuar nevojat, kriteret e në ndryshim duhet të këtë pjesëmarrje edhe të aktereve të tjerë , organizata tjera që na mbështesim me ndonjë model si OSBE etj. Legjislaturave të kaluara nuk ju besoj shumë sepse ju kanë dhënë detyra vetes, duhet me ditë cilat janë përgjegjësitë ligjore ndaj qytetarëve. Zyra për informim duhet të këtë rolin e vet, pastaj Kuvendi duhet me pas zyrtarin e vet për informim

Salih Elshani OSBE: Në këtë proces OSBE në bashkëpunim me Asociacionin e Komunave të Kosovës është mbajtur punëtori me kolegjiunet e zyrave për informim ku kanë marrë pjesë zyrtaret e Komunave. Aty është përpiluar një model për krejt Komunitet dhe ju është shpërndarë.

Ju falënderoj për pjesëmarrje.

Hashim Vrenezi: Rregullorja është e mire por nuk po zbatohet.

Raimonda Krasniqi: A duhet që në rregullore të përfshihet që drejtoret e drejtorive duhet të marrin pjesë nëpër mbledhje pasi që ata nuk po janë asnjëherë prezent në KPF, vetëm i sjellin pikat e veta.

Rahim Morina: Kush jeni për rekomandimin e kësaj pikë për mbledhjen e Kuvendit? Unanimisht ishin 4 anëtar të pranishëm.

7. Shqyrtimi i kërkesave.

Kërkesa nr.02/477 datë:23.08.2019 e parashtruar nga Kryesuesi i Komisionit Komunal të Aksionarëve për mbështetje financiare për funksionalizimin e Bordit të Drejtorëve të NPK “ Stacioni i Autobusëve” SH.A në Malishevë.

Alban Krasniqi: Sot kemi mbajtur një mbledhje komisioni i Aksionarëve dhe kemi vendosur me anuluar një konkurs të shpallur më herët, atje në Stacion tani ska as kushte për punë ne kemi kërkuar nga kryetari të sjellë një zyrtar në panel, na ka penguar edhe në ofrim të dokumenteve. Nuk kemi mund me siguruar një profesionist të jashtëm, plani b ka qenë të caktohet një bord i përkohshëm por anëtarët e bordit duhet të paguhet për punën e vet. Që të funksionoj bordi duhet rregullimi i hapësirës për mbledhje, duhet hapësirë për dokumente e në kërkesë kemi kërkuar mjete për me mujt me funksionuar në kryerjen e detyrave.

Rahim Morina: Kush jeni për rekomandimin e kësaj kërkesë për mbledhjen e Kuvendit? Unanimisht ishin 4 anëtar të pranishëm.

Kërkesa nr.02/468 datë: 16.08.2019 e parashtruar nga Kryesia e fshatit Carrallukë, për ndërtimin e rrethrotullimit në vendin ku kryqëzohet rruga “Hilmi Hoti” me trasenë e transitit.

Rahim Morina: Kush jeni për rekomandimin e kësaj kërkesë për mbledhjen e Kuvendit? Unanimisht ishin 4 anëtar të pranishëm.

Kërkesa nr.02/471 datë:20.08.2019 e parashtruar nga Kryesia e fshatit Llazicë, lagja Buzhala, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e shtëpisë (odës) së pritjes për komunitetin e lagjes Buzhala dhe për ndërtimin e parkut.

Alban Krasniqi: Në këtë kërkesë janë dy aspekte njëra për caktimin e një hapësire për një shtëpi dhe për një park. Nëse rekomandohet për Kuvend të dihet saktë vendi se ku ka mu ndërtuar.

Rahim Morina: Kush jeni për rekomandimin e kësaj kërkesë për mbledhjen e Kuvendit? Unanimisht ishin 4 anëtar të pranishëm.

Kërkesa nr.02/436 datë:12.07.2019 e parashtruar nga zj. Lumturije Berisha nga fshati Drenovc, për mbështetje financiare për shërim.

Rahim Morina: Kush jeni për rekomandimin e kësaj kërkesë për mbledhjen e Kuvendit? Unanimisht ishin 4 anëtar të pranishëm.

Kërkesa nr.02/474 datë:22.08.2019 e parashtruar nga Shaban Kryeziu nga fshati Bubavec, për ndihmë financiare për nënën e tij.

Rahim Morina: Kush jeni që kjo kërkesë të miratohet me 700 euro? Unanimisht ishin për 4 anëtarët prezent.

Kërkesa nr.02/441 datë: 16.07.2019 e parashtruar nga Haxhi Gashi nga fshati Balincë, për ndihmë financiare.

Alban Krasniqi: Për çdo kërkesë kemi thënë se mirë është të pajisemi me dokumentacion.

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo kërkesë t'i përcillet Kryetarit të Komunën për shqyrtim të mëtutjeshëm? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/473 datë:21.08.2019 e parashtruar nga kryesia e fshatit Kijevë për ndërtim të çerdhes për fëmijë.

Alban Krasniqi: Të kërkohet një mendim edhe nga Drejtoria për Arsim dhe gjithsesi nga Drejtoria për Gjeodezi të kërkohet sipërfaqe ku dhe sa vend.

Kërkesa nr.02/445 datë: 18.07.2019 e parashtruar nga z. Egzon Gashi nga fshati Ngucat për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Kërkesa nr.06/67 datë: 17.06.2019 e parashtruar nga z. Kaqanik Balaj nga Komuna e Istogut për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në zonën kadastrale në fshatin Mleqan KK.Malishevë.

Rrahim Morina: Nëse mendoni i rekomandojmë për kuvend edhe pse nga drejtoritë kanë kërkuar të plotësohen me material.

Kush jeni për rekomandim të dy kërkesat për ndërrim destinim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore? Unanimisht ishin për.

8. Të ndryshme.


Rrahim Morina: Tani jemi në kohën kur duhet të fillojnë edhe procedurat e dëgjimeve publike rreth buxhetit që duhet të miratohet në kuvend. unë do t'ju bëj kërkesë drejtorit të financave dhe kryetarit të Komunës, unë po ju lexoj edhe shkresën e Ministrisë lidhur me procedurat rreth buxhetit.

Ju falënderoj për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11.30 minuta.

Procesmbajtësi

Naim Avdijaj jur. i dip



Kryesuesi i Kuvendit

Rrahim Morina

